

SYLLABUS i Lëndës: E drejta E Pronësisë

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta E Pronësisë
Niveli:	Master: Drejtimi Civil dhe Pronësor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I/Master
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	/
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha
Detajet kontaktuese:	qerkin.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda <i>E drejta e Pronësisë</i> përfshinë trajtimin në mënyrë bashkëkohore të të drejtës pronësore në përgjithësi dhe të pronësisë në veçanti dhe të institucioneve tjera juridike të të drejtës pronësore. Ligjëratat dhe seminarat nga kjo lëndë do të mbahen një herë në javë nga dy ore. Mësimi organizohet në semestrin e parë të studimeve Master. Kjo lëndë është lëndë e obligueshme. Studentëve u ofrohen njohuri teorike dhe praktike për çështjet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore.
Qëllimet e lëndës:	
	Qëllimet e lëndës konsistojnë në dhënien e mundësisë studentëve të Studimeve Master – drejtimi - civil dhe pronësor, për të kuptuar sa më mirë fushën e të drejtës së pronësisë, për të zhvilluar vetëdijen te studentët për zbatimin e dispozitave me të cilat rregullohen çështjet e pronësisë. Studentët do të kenë mundësi që me qasje logjike dhe në mënyrë analitike t'i zgjidhin detyrat të cilat kërkohen në fushën e të drejtës së pronësisë. Te studentët do të zhvillohen shkathtësitë për qasje kritike për ligjin dhe argumentimin ligjor në fushën e të drejtës së pronësisë. Praktika gjyqësore po ashtu do të elaborohet nga studentët Master
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptoj nocionet dhe institutet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore si: servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe barrëve sendore. 2. Të jenë në gjendje për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore nga fusha e të drejtës pronësore; 3. Të paraqes argumente verbale dhe me shkrim në çështjet e të drejtës së pronësisë në emër dhe për llogari të klientëve afarist. 4. Të jenë në gjendje të kryen punë praktike në

	institucione të ndryshme të ndërlidhura me çështjet afariste: si gjykata komerciale, arbitrazhe, institucione financiare etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15
Kollokfiime,seminare	2	2/5	10
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projektet,prezentimet ,etj	10	1/1	10
Totali	5 ECTS	Total	150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>E drejta e pronësisë do të mësohet përmes ligjëratave dhe seminareve duke mos i përjashtuar edhe forma tjera të mundshme. Ligjërata do të paraqes metodën e prezentimit të rregullave themelore hyrëse dhe të përmbajtjes të rregulluar me të drejtën pozitive të Republikës së Kosovës, të drejtës ndërkombëtare dhe duke bërë krahasime edhe në të drejtën komparative të pronësisë. Seminaret do të jenë një proces interaktiv i mësimi për studentët, bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimdhënësit të lëndës. Trajtimi i shembujve të ndryshëm do të ketë për qëllim lehtësimin e të kuptuarit të të drejtës së pronësisë nga studentët. Përmes ligjëratave dhe seminareve studentët do të inkurajohen që të kenë qasje kritike ndaj ligjit dhe vendimeve gjyqësore me të cilat zgjidhen çështje nga lëmi i të drejtës së pronësisë. Studentëve u kërkohet që të shkruajnë së paku nga dy punime të cilat kanë të bëjnë me ndonjërin prej çështjeve apo temave të trajtuara gjatë ligjëratave. Kjo paraqet një pjesë të rëndësishme dhe të detyrueshme. Pjesa e punës së shkruar do të llogaritet në vlerësimin final të studentit.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi do të bëhet përmes pjesëmarrës, angazhimit në seminar, angazhimit në rast të studimit, dhe provimi përfundimtar.</p>		

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Pjesëmarrja e studentëve</i> 10% - <i>Seminari</i> 10% - <i>Rasti i studimit</i> 20% (10% rastet e studimit në klasë dhe 10% rastet e studimit detyrë shtëpie) - <i>Provimi përfundimtar</i> 60% (provimi përfundimtar organizohet në formë me shkrim i cili përbëhet nga 50% e pikëve pyetje alternative dhe të hapura, 25% ese dhe 25% rast i shkurtër studimi. Kalueshmëria me 60% e pikëve të fituara). <p><u>Ndërtimi i notës:</u></p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> • % • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 </td> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> • Nota • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë) </td> </tr> </table>	<ul style="list-style-type: none"> • % • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 	<ul style="list-style-type: none"> • Nota • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë)
<ul style="list-style-type: none"> • % • 91-100 • 81-90 • 71-80 • 61-70 • 51-60 	<ul style="list-style-type: none"> • Nota • 10 (dhjetë) • 9 (nëntë) • 8 (tetë) • 7 (shtatë) • 6 (gjashtë) 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Aliu, A : <i>E Drejta Sendore</i> (Pronësia), Prishtinë, 2014 • Galgano F.: <i>E Drejta Private</i>. Tiranë, 1999. 		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Gams A.: <i>Bazat e së Drejtes Reale</i>. Prishtinë, 1978. • Statovci E.: <i>Marrëdhëniet pronëso- juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës</i>. Prishtinë, 1977. • Statovci E.: <i>Mbrojtja e Pronësisë: studim komparativ</i>. Prishtinë, 1980. • Statovci E.: <i>Pronësia, origjina dhe zhvillimi (komparativ)</i>. Prishtinë, 1983 • Statovci E.: <i>E drejta e servituteve</i>. Prishtinë, 1985. • Shehu A.: <i>Pronësia</i>. Tiranë, 2000. • Gavella N., Josipovic T., Gliha I., Belaj V., Stipković Z.: <i>Stvarno pravo</i>. Zagreb, 1998. • Gelevski, S.: <i>Zakon za sopstvenost i drugi stvarni prava – so komentar i sudska praktika</i>. Shkup, 2002. • Vedris M.; Klaric, P.: <i>Gradjansko pravo</i>. Zagreb, 1999. • Weill A.: <i>Droit civil – les biens</i>. Paris, 1974. • Edëard H. Rabin, Roberta Rosenthal Këall dhe Jeffrey L. Këall: <i>Fundamentals of Modern Property Law</i>. New York, 2000. • Tekstet ligjore: • Kushtetuta e Republikës së Kosovës • “Zakon za sopstvenost i drugi stvarni prava”, <i>Sluzhbeni Vesnik na RM</i>, Nr. 18/2001. 		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në të drejtën e pronësisë		
<i>Java e dytë:</i>	Kuptimi i të drejtës së pronësisë		

<i>Java e tretë:</i>	E drejta e pronësisë dhe sistemet juridike në botë
<i>Java e katërt:</i>	Burimet e të drejtës së pronësisë
<i>Java e pestë:</i>	Sendet
<i>Java e gjashtë:</i>	Posedimi
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I
<i>Java e tetë:</i>	Llojet e pronësisë
<i>Java e nëntë:</i>	Fitimi i pronësisë
<i>Java e dhjetë:</i>	Mbrojtja e pronësisë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Shuarja e pronësisë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	E drejta e servituteve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Hipoteka
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Regjistrat publik për regjistrimin e të drejtës së pronësisë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Integriteti akademik:

Gjate procesit mësimor dhe atij të vlerësimit të studentëve përfshirë edhe kontaktet tjera me student që ndërlidhen me raportet studimore, mesimdhënesi duhet të ruaj integritetin e tij akademik dhe të tregoj vlera të larta morale dhe njerëzore si dhe të jete i paanshëm dhe të jete në gjendje që të përballlet me çdo sfidë në këtë drejtim nga çdo ndikim apo presion që mund t'i behet nga të tjerët. Studentet janë të obliguar t'i përmbahen rregullave të mirësjelljes si gjate ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit, në të kundërtën mund të rrezikojnë të jenë palë në procedurat disiplinore sipas rregullave të Fakultetit Juridik dhe rregullave të Universitetit të Prishtinës.

Plagjiatura paraqet shkelje të rëndë, andaj konstatimi i së njëjtës paraqet bazë të mjaftueshme nga përjashtimi nga lënda në fjalë!